



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të datës 4 Qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në Njoftimin e datës 21.10.2024 Nr.01-462/01-52614 të Fluidi Group L.L.C, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2024 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT Nr.15-462/01-35825 DATË 25.07.2024 PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

1. SHFUQIZOHET, Vendimi Nr.15-462/01-35825 datë 25.07.2024 të Kuvendit të Komunës së Lipjanit, për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, duke u bazuar në Njoftimin e datës 21.10.2024 Nr.01-462/01-52614 të Fluidi Group L.L.C, për tërheqjen nga procesi i nënshkrimit të kontratës.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronëso-ro-Juridik.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza juridike për ta propozuar dhe miratuar këtë propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Ofertuesi Fluidi Group L.L.C me Nr. biznestit 811582651 adresa Velekincë-Gjilan me pronar Berat Mustafa, është përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për marrjen e parcelës komunale P-71409036-00164-15 me sipërfaqe prej 13000 m² në ZK Konjuh, në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, dhe në emër të kompanisë Fluidi Group L.L.C Shkumbin Mustafa, përmes emailit zyrtar datë 20/10/2024, protokoluar me datë 21.10.2024 Nr.01-462/01-52614 në arkiven e Komunës, kanë njoftuar Zyrën e Kryetarit- Sektorin Pronëso-ro-Juridik, për tërheqjen nga procesi i nënshkrimit të kontratës, për arsyet e ndryshimeve dhe amendamentimet e disa neneve specifike të draft- kontratës në njoftimin i cili i bashkangjitet këtij propozim-vendimi.

Prandaj, bazuar në arsyet e theksuara më lartë dhe konform dispozitave ligjore në fuqi, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij propozim-Vendimi.

Nr. 01-462/01-55012

Lipjan, më 04.11 .2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti



Draft Kontrata

REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN

Lumnije Ejupi

Pranuar me: Primijeno:	21. 10. 2024	
Njesia Jednic:	Numri Sroj	Shtojca Dodatak
01-462/01-52614		

Today, 18:48

Legal Departament <legal@fluidigroup.com>

Reply all

Fri 18/10, 01:41

Lumnije Ejupi;

Gafurr Hetemi;

Hazbi Ademi;

Shkembim Mustafa <shkembim@fluidigroup.com>

You forwarded this message on 20/10/2024 18:48

Label: DelFiveYOldEm (5 years) Expires: 17/10/2029 01:41

Caution! This message was sent from
outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Të nderuar,

Në emër të kompanisë Fluidi Group LLC, me numër unik identifikues 811582651, ju drejtohem për t'ju njoftuar në mënyrë formale **për tërheqjen tonë nga procesi i nënshkrimit të kontratës** për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, Njësia Kadastrale P-71409036-00164-15, me sipërfaqe prej 13,000 m² në Zonën Kadastrale Konjuh.

Gjatë gjithë procesit të negocimit, kemi vërejtur vonesa të konsiderueshme, si në fazën e përzgjedhjes, ashtu edhe në procedurat e miratimit të saj. Për fat të keq, këto vonesa kanë krijuar një ambient pasigurie për ne si kompani dhe për partnerët tanë strategjikë. Disa nga bashkëpunëtorët tanë janë tërhequr nga ky projekt për shkak të afateve të zgjatura dhe mungesës së progresit të pritur.

Gjithashtu, ne kemi shprehur në mënyrë të vazhdueshme kërkesat tona për ndryshimet dhe amendamentimet e disa neneve specifike të kontratës, të cilat konsiderojmë të jenë të rëndësishme për të siguruar qartësi dhe siguri në marrëdhënien e ardhshme kontraktuale. Përkundër përpjekjeve tona për të arritur në një marrëveshje të balancuar, mungesa e mbështetjes dhe fleksibilitetit nga ana e Komunës ka bërë që ne të mos e shohim më të përshtatshme vazhdimin e këtij procesi.

Duke marrë parasysh të gjitha këto faktorë, me keqardhje, ju informojmë që kompania Fluidi Group LLC tërhiqet nga procesi i nënshkrimit të kësaj kontrate. Ky vendim është i domosdoshëm për të mbrojtur interesat tona afariste dhe për të minimizuar rreziqet që lidhen me vonesat dhe pasiguritë e krijuara.

Ne mbetemi të hapur për bashkëpunime të tjera të mundshme në të ardhmen, në kushte më të favorshme dhe më të qarta, që përmbushin interesat e të dyja palëve.

Me respekt dhe përshëndetje,

Saqip MURTEZI

Legal Officer & HR Manager

Rr. E Presheves , Velekincë– Gjilan 60000

Mob:+383 49 121 368

legal@fluidigroup.com

info@fluidigroup.com / www.floil-ks.com / www.fluidigroup.com

Consider the environment before printing.

[EN] The information contained in this e-mail is privileged and confidential information intended for the intended recipient only. If you are neither the intended recipient, nor the employee or agent responsible for delivering this message to the intended recipient (or have received this e-mail in error) please reply and notify the sender immediately and delete this e-mail. Any unauthorized copying, disclosure, distribution or the taking of any action in reliance on the contents of this e-mail is strictly prohibited.

Lumnije Ejupi

Mon 07/10, 23:54

Të nderuar, Lidhur me komentet e dërguara përmes emailit zyrtar, përkitazi me draft kontratën për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës Njësia Kadastrale P-71409036-00164-15 me sipërfaqe prej 13000 m2 në Zonën Kadastrale Konjuh,

Legal Departament <legal@fluidigroup.com>

Mon 30/09, 23:26

Të nderuar, Ju falënderojmë për takimin e mbajtur dje. Në vijim të diskutimeve tona, ju lutem gjeni të bashkëngjitur kontratën e përditësuar, e cila përmban kërkesat tona për ndryshimet e propozuara. Caution! This message was sent from outside your organization.

Legal Departament <legal@fluidigroup.com>

Thu 26/09, 22:49

Përshendetje te nderuar, Konfirmoj pranimin e draftit te Kontrates, gjithashtu pjesemarrjen ne takim te henen. Dite te mbare, On Fri, 27 Sept 2024, 11:34 Gafurr Hetemi, wrote: Përshendetje, uroj dhe Caution! This message was sent from outside your organization.

Gafurr Hetemi

Thu 26/09, 21:34

Përshendetje, uroj dhe shpresoj të jeni mirë dhe punë t'ju ecin mbarë, pas përfundimit të Draft-kontratës, Ju mirëpresum me datë 30.09.2024 ditë e Hënë, në ora 14:30 në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Lipjani-Sektorit Pronëso-ro-Juridik, për mesë këtij email



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 5 pika 1.paragrafi 1.3, nenit 6 paragrafi 3, nenit 13, nenit 21 paragrafi 5 dhe 6 dhe nenit 22 të Rregullores QRK NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____2024 të miratojë këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET oferta e përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

1.Fluidi Group L.L.C, me nr. biznosit 811582651 adresa Velekincë-Gjilanë, me pronar Berat Mustafa, shfrytëzues i pronës të paluajtshme të Komunës.

2.Prona e paluajtshme e Komunës, gjenden në ZK Konjuh, të përshkruar nga evidenca kadastrale përkatëse si në tabelën në vijim:

Nr	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqe për shfrytëzim m ²
1.	Komuna Lipjan	P-71409036-00164-15	Konjuh	13000

3.Shfrytëzimi i pronës komunale do të jetë 99 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

4.Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës komunale, destinohet kryesisht për ndërtimin e fabrikës për prodhimin e shtëpive modulare me standardin mjedisor A +++ në Lipjan, sipas planit të përshkrimit detaj të projektit nga Biznesi Fluidi Group L.L.C.

Neni 2

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso-ro-Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Inspektionit dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës. nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij propozim-Vendimi.


Nr. 15-462/01-35825

Lipjan, më 25.07.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Ud. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erblin Hetemi, Ud. Udhëheqës Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL.	Data: 31.07.2024 VI-020-486
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorim të Komunave	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit	
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Lipjanit	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 15 Nr.462/01-35825 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komune së Lipjanit
I miratuar më datë: 25.07.2024
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 26.07.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyctim

Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2024, ka miratuar Vendimin 15 Nr.462/01-35825 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komune së Lipjanit i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit.

MATL, konstaton se vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit është bazuar me nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 19 paragrafi 3 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 5 pika 1 paragrafi 1.3, nenin 6 paragrafi 3, nenin 13, nenin 21 paragrafi 5 dhe 6 dhe nenin 22 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Vendimi 15 Nr.462/01-35825 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komune së Lipjanit të miratuar me datë 25.07.2024 në mbledhjen e Kuvendit me, 23 vota për, 5 kundër dhe 1 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çlarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.